



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME – VRHOVNI SUD

GJS-2023-017

Ushtruesja e Detyrës së Kryetarit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës - Mejreme Memaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 dhe paragrafi 6 i Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga avokatja A.H., kundër vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren, më 22.06.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet si e pa lejuar, ankesa e avokates A.H., paraqitur kundër vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore të Prizren, AD/GJTHPZ.nr.11/23 datë 11.05.2023.

A r s y e t i m

Në këtë Gjykatë me 19 qershor 2023 është pranuar ankesa e avokates A.H., e paraqitur kundër vendimit AD/GJTHPZ.nr.11/23 datë 11.05.2023, të Gjykatës Themelore në Prizren-respektivisht Kryetares së kësaj gjykate –Sh.E., me të cilin është refuzuar ankesa e avokates së lartcekur për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit G.Sh..

Ushtruesja e Detyrës së Kryetares së Gjykatës Supreme pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të cilat i janë bashkangjitur ankesës, vlerëson se:

-Ankesa nuk është e lejuar.

Nga shkresat e çështjes del se avokatja A.H., ka ushtruar ankesë ndaj gjyqtarit G.Sh. - gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil dhe kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore ndaj tij.

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren, si autoritet kompetent për të vendosur lidhur me ankesën konform dispozitës së nenit 9 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve duke vendosur përkitazi me ankesën me vendimin AD/GJTHPZ.nr.11/23 datë 11.05.2023 e ka refuzuar atë si të pabazuar.

Ndaj vendimit të lartcekur në këtë gjykatë ka ushtruar ankesë avokatja A.H., për shkak të trajtimit të padinjitetshëm të kërkesës dhe ankesës kundër gjyqtarit G.Sh., me propozim që kjo Gjykatë të aprovoj ankesën, kurse të urdhërohet dhe të rivendoset për ankesat e refuzuara, dhe të iniciohet procedura disiplinore ndaj Kryetares së Gjykatës.

Duke pas parasysh këtë gjendje të çështjes vlerësoj se ankesa e avokates në rastin konkret nuk është e lejuar për këto arsye:

Sipas Ligjit nr.06/L-057 “Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” respektivisht nenit 9 par.1 të këtij ligji - secili person fizik dhe juridik mund të parashtrij ankesë ndaj një gjyqtari tek Autoriteti Kompetent apo tek Avokati i Popullit, i cili duhet që ankesën ta përcjell tek Autoriteti Kompetent. Po ashtu, sipas këtij ligji - nenit 9 par.6 të tij autoriteti kompetent shqyrton ankesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës dhe vepron në përputhje me nenin 12 par.2 (e fillon procedurën disiplinore kur vlerëson se ka bazë), përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Kurse, edhe sipas Rregullores (05/2019) nenit 7 par.1 të kësaj Rregulloreje pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare, Autoriteti Kompetent ankesën mund ta hudh, refuzon, ose të kërkojë nga Këshilli fillimin e hetimeve. Mirëpo, me asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet se në rastet kur autoriteti kompetent e refuzon ankesën për inicim të procedurës disiplinore ankuesi mund të ushtroj në ankesë ndaj këtij vendimi.

Bazuar në këto rrethana, duke vlerësuar ankesën e parashtruar ndaj vendimit të Kryetares së Gjykatës Themelore në Prizren së bashku me shkresat e bashkëngjitura vlerësoj se ankesa është e palejuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Mejreme Memaj
U.D. Kryetare e Gjykatës Supreme

Kopje:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
2. Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prizren.
3. Palës ankuese,
4. Arkivit të Gjykatës Supreme.